

**"ADMINISTRATA PUBLIKE NË KOSOVË,
PARIMET E ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMI DHE REFORMAT
NË PROCESIN E INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN"**

**TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SHKENCËS NË ADMINISTRATË PUBLIKE DHE
INTEGRIME EVROPIANE**

NGA

DORENTINA PIREVA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

Departamenti i Shkencave Politike

Integrime Evropiane dhe Administratë Publike

Prishtinë, Tetor 2022

REZYME

"ADMINISTRATA PUBLIKE NË KOSOVË, PARIMET E ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMI DHE REFORMAT NË PROCESIN E INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN"

Mentori: Prof.Dr Afrim Hoti

Studimi ka për qëllim të shpjegojë rolin e administratës publike si faktor esencial dhe kusht kryesor për integrimin në Bashkimin Evropian. Hulumtimi në mënyrë gjithëpërfshirëse duke u ndalur në secilin kapitull shpjegon rëndësinë e veçantë, që kanë parimet, konceptet dhe llojet e kontrollit të administratës publike. Përpos kësaj hulumtimi si qëllim të dytë ka edhe studimin e administratës, rolit dhe zhvillimit të saj në Republikën e Kosovës. Kosova si shtet i ri duhet të gjejë mënyrat më efektive për implementimin e marrëveshjeve themelore ndërkombëtare, dhe përmbushjen e kriterëve *acquis* për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian. Rruga për të arritur tek një administratë transparente, efikase, dhe llogaridhënëse padyshim që është e gjatë dhe kërkon mënyrat më të përshtatshme, për vendosjen e rendit përbrenda gjitha institucioneve publike apo private, dhe me një barazi të plotë mes të gjithë atyre që shërbejnë përbrenda këtyre institucioneve. Strategjia kryesore e një administrate efikase duhet të jetë bashkëpunimi dhe harmonizimi i interesave të njëjta mes individëve dhe përfaqësuesve të shtetit. Rol të rëndësishëm kanë edhe të gjitha ato lloje të praktikave dhe formave të cilat mundohen t'i ngjasojnë modelit dhe shembullit të vendeve të BE-së. Kosova si shtet ka një rrugë përpara për përmbushjen e këtyre parimeve dhe detyrave të cilat i janë përcaktuar, në mënyrë që në të ardhmën të ketë një administratë publike efikase.

Punimi është realizuar brenda intervalit kohor Qershor-Tetor 2022, i ndarë në pesë kapituj kryesor dhe 77 faqe.

Në kapitullin e parë- të këtij punimi do të shtjellojmë metodologjinë hulumtuese sipas së cilës është realizuar ky punim. Rreth qëllimit, arsyes së përzgjedhjes së temës e deri tek mundësia për t'u përgjigjur pyetjeve hulumtuese të parashtruara në formën më të suksesshme të mundshme.

Në kapitullin e dytë- do të fokusohemi kryesisht në mënyrë më të detajuar mbi punën që shtrun administrata si sistem, si kanë ndryshuar nocionet dhe konceptet e saj përgjatë kohës e deri në ditët e sotme moderne.

Në kapitullin e tretë- format se si administrata arrin të kontrollojë punët e saj, sa është e suksesshme në këto lloje kontrolli dhe sa transparente.

Në kapitullin e katërt- parimet e punës së drejtë të administratës janë faktor kyç në funksionimin e saj të pavarur dhe në kuadër të respektimit të ligjit dhe ndërveprimit të ngushtë me të, prandaj do të arrijë të shpjegojë këto parime dhe rolin esencial në punën për të cilën varet edhe administrata.

Në kapitullin e pestë- do ndalem të shpjegoj gjendjen e administratës publike në Kosovë, sa Kosova ka arritur të tregohet e suksesshme për krijimin e një administrate, mundësinë e funksionimit të jetë sa më e afërt në plotësimin e parimeve *acquis* të vendosura nga BE, si kriter kryesor integrimin brenda saj.

HIPOTEZAT DHE PYETJET HULUMTUESE

Pyetja hulumtuese 1: Sa është treguar e suksesshme Kosova në implementimin e reformave dhe kritereve *acquis* të vendosura nga Bashkimi Evropian për të qenë pjesë e integritit evropian?

Pyetja hulumtuese 2: Si është e organizuar administrata në përgjithësi, në cilat parime dhe rregulla bazohet funksionimi i saj?

Hipoteza 1: Reformat e vendosura nga Bashkimi Evropian kanë arritur të ndryshojnë administratën publike të Kosovës, në mënyrë funksionimi dhe organizmi, mirëpo gjatë implementimit dhe zbatimit të tyre ka pasur probleme.

Hipoteza 2: Një shtet për të funksionuar në mënyrë të suksesshme duhet të ketë një administratë publike e cila bazohet në organizimin, përgjegjshmërinë dhe nivelin kualifikues.

